

1 E martë, 22 mars 2022

2 [Deklarata Hyrëse e Mbrojtjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

5 --- Fillon në orën 9.32

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

7 Sekretare, ju lutem paraqitni lëndën.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita të nderuar

9 Gjykatës. Kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-05, Prokurori i  
10 Specializuar kundër Salih Mustafës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit znj. Sekretare.

13 Në fillim të paraqiten të pranishmit.

14 Fillojmë me Prokurorinë.

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mirëdita. Përfaqësohemi sot me  
16 Silvia D'Ascolin, ndihmësprokurore; Line Pedersen, menaxhere e  
17 lëndës dhe unë jam Cezary Michalczuk, Prokuror i ZPS-së.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

19 Faleminderit.

20 Znj. Mbrojtëse e Viktimave, keni fjalën.

21 ZNJ. PUES: [Përkthim] Mirëdita të nderuar Gjykatës.

22 Mirëdita të gjithëve. Viktimat pjesëmarrëse përfaqësohen sot  
23 nga Brechtje Vossenber, bashkëmbrojtëse dhe unë, Anni Pues si  
24 Mbrojtëse.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

1 Avokat i Mbrojtjes keni fjalën.

2 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëdita e nderuar Gjykatëse.  
3 Mbrojtja përfaqësohet sot nga z. Betim Shala, bashkëmbrojtës;  
4 Z. Fatmir Pelaj, përkthyes dhe hetues; dhe unë Julius von  
5 Bone. Me videolidhje na bashkohet sot dhe z. Mustafa.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
7 Faleminderit, Avokati i Mbrojtjes.

8 Z. Mustafa, na dëgjoni në rregull?

9 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, znj. Gjykatëse.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
11 mirë. Për procesverbalin, ky proces zhvillohet përpara Trupit  
12 Gjykues numër 1.

13 Gjykatësi Mikula merr pjesë përmes video lidhjes. Janë  
14 instaluar pajisjet në mënyrë që ai t'i ndjekë procedurat si në  
15 seancë publike ashtu dhe në seancë private dhe të mbyllur.

16 Seanca sot zhvillohet për deklaratën hyrëse të Mbrojtjes,  
17 siç parashikohet edhe nga Rregullorja.

18 Përpara kësaj dëshiroj që të diskutoj diçka.

19 Znj. Sekretare, ju lutem të kalojmë në seancë private.

20 [Seancë private]

21 [Seancë private teksti i fshirë]

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17 [Seancë e hapur]

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

19 jemi në seancë publike.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Faleminderit znj. Sekretare.

22 Do të fillojmë tani me deklaratën hyrëse të Mbrojtjes.

23 Sipas urdhrit të Trupit Gjykues të datës 9 mars, Mbrojtja ka 2

24 orë në dispozicion për deklaratën hyrëse. Mbrojtjes i është

25 autorizuar dhe përdorimi i mjeteve pamore dhe mjeteve të

1 tjera. Të gjitha këto materiale janë nxjerrë tashmë. Trupi  
2 Gjykues thekson se ky material nuk do t'i paraqitet publikut.

3 Krahas kësaj, Mbrojtja ka komunikuar se i akuzuari nuk do  
4 të mbajë ndonjë deklaratë sot.

5 Z. von Bone, keni fjalën.

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit e nderuara  
7 Gjykatëse.

8 Të nderuar Gjykatës. Mbas shpërbërjes së Jugosllavisë,  
9 lufta për pavarësinë e Kosovës mori dy forma: Një lëvizje  
10 paqësore që mbulon periudhën nga viti 1990 deri në mars të  
11 vitit 1998; dhe lëvizja e rezistencës në të dytën. Kjo e dyta  
12 mori stafetën nga e para në momentin e eliminimit të Adem  
13 Jasharit dhe të familjes së zgjeruar të tij, kryesisht fëmijë  
14 dhe gra. Kjo nxiti konsolidimin e rezistencës në përpjekjen e  
15 saj për pavarësi.

16 Adem Jashari konsiderohet si komandanti legjendar i UÇK.  
17 Përpjekjet e tij patriotike dhe heroike për çlirimin e Kosovës  
18 mbahen mend edhe sot e kësaj dite në Kosovë për çlirimin nga  
19 një regjim shtypës dhe brutal.

20 Më datë 5, 6 dhe 7 mars të vitit 1998, forcat ushtarake  
21 dhe policore sulmuan kompleksin e familjes së Adem Jasharit në  
22 Prekaz të zonës së Drenicës. Forcat serbe mendonin se me  
23 vrasjen e të gjithë familjes Jashari, rezistenca e popullit  
24 kosovar do të kishte marrë një goditje përfundimtare, aq sa  
25 edhe do të ndalonte rezistenca. Vrasja në masë e 59 njerëzve

1 në kompleksin e familjes Jashari, mes të cilëve edhe shumë  
2 fëmijë, disa prej të cilëve jo më shumë se 7 vjeç, është një  
3 prej krimeve më të këqija të regjimit serb të kryera  
4 ndonjëherë në Kosovë. Edhe njerëz të tjerë të cilët banonin në  
5 kompleks, si anëtarë të moshuar apo farefis të familjes,  
6 humbën jetën në këtë sulm të paprecedentë kundër një shtëpie  
7 rezidenciale 2 katesh e cila ndodhej në kodrat e Prekazit.

8 Ky sulm ka lënë një shenjë të rëndësishme dhe themelore  
9 në historinë e Kosovës në përpjekjet e saj për t'u çliruar nga  
10 ky regjim shtypës. Me shumë gjasë, vrasja e të gjithë familjes  
11 nga forcat serbe, shërbeu si një pikë kthese në rezistencën e  
12 popullit të Kosovës.

13 Sulmi brutal nga një regjim shtypës, hasi në një  
14 rezistencë të fortë, me një mbështetje të gjerë në popullatën  
15 e Kosovës. Shumë e shumë njerëz dolën vullnetarë për të marrë  
16 pjesë në një përpjekje të armatosur për t'u çliruar nga  
17 regjimi i cili e kishte mbajtur këtë popullatë me një grusht  
18 të hekurt prej shumë vitesh.

19 Pas një viti, më 24 mars të vitit 1999 - që është si sot  
20 përpara 23 vjetësh - NATO filloi sulmet e veta ajrore për të  
21 çliruar Kosovën nga ky regjim shtypës. Sulmet ajrore të NATO-s  
22 zgjatën deri në qershor të vitit 1999. Sulmet ajrore të NATO-s  
23 u nxitën nga gjakderdhja dhe spastrimi etnik kundër  
24 shqiptarëve në Jugosllavi, çka i shtyu shqiptarët që të  
25 largohen drejt vendeve fqinjë. Operacionet e NATO-s ishin një

1 ndërhyrje humanitare e cila u bë e nevojshme kur Jugosllavia  
2 refuzoi që të nënshkruante Marrëveshjen e Rambujesë. NATO i  
3 justifikoi veprimet e veta si veprime të cilat po kryheshin  
4 për të parandaluar një katastrofë humanitare të madhe.

5 Sulmet e NATO-s në Prishtinë më 24 mars 1999, janë të  
6 mirënjohura prej secilit prej qytetarëve të Kosovës të cilët  
7 mbetën gjallë nga konflikti. Megjithatë, forcat serbe nuk i  
8 ndaluan veprimet e tyre për spastrim etnik të asaj kohe. Ato  
9 vazhduan në mënyrë të rregullt dëbimin me forcë të qytetarëve  
10 kosovarë me kombësi shqiptare nga shtëpitë e tyre.

11 Data më e rëndësishme në këtë kuadër është depërtimi në  
12 masë të madhe i shqiptarëve nga stacioni i trenit të  
13 Prishtinës. Më 31 mars 1999, që është një tjetër ditë e  
14 ngulitur thellësisht në mendjet e shumë qytetarëve kosovarë,  
15 ka ndodhur kjo, që ishte dhe një ngjarje me rëndësi në Kosovë.

16 Kjo është përshkruar si një prej ngjarjeve të rëndësishme  
17 në raportet e OSBE-së, të cilat mund t'i gjeni në dosjen e  
18 çështjes. Bëhet fjalë për spastrimin e lagjeve të Prishtinës.

19 Në raporte thuhet kështu:

20 "Raportime të shumta" - po citoj nga raporti:

21 "Raportime të shumta por të pakonfirmuara, bëjnë të  
22 ditura se familjet me kombësi shqiptare detyrohen me forcë që  
23 të largohen nga shtëpitë e tyre në mënyrë sistematike nga  
24 lagjet dhe po i dërgojnë në stadiumin sportiv të Prishtinës.  
25 Disa grupe dërgohen drejtpërdrejtë në stacionin e trenit për

1 të vazhduar pastaj në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

2 Grupe të mëdha civilësh të armatosur serb, disa me  
3 uniforma të sajuara, raportohet se janë përfshirë në këto  
4 dëbime, si edhe në ngacmimin e përgjithshëm kundër personave  
5 me kombësi shqiptare dhe në plaçkitjen dhe vandalizmin e kryer  
6 ndaj shtëpive dhe dyqaneve të tyre. Kjo mënyrë pune me sa  
7 duket ka për qëllim që të frikësojë kosovarët, në mënyrë që  
8 ata të largohen nga vendbanimet e tyre, me anë të djegies së  
9 ndërtesave dhe të shtënave me armë. Pas largimit, kosovarët  
10 drejtohen që të shkojnë në stacionin e trenit të Prishtinës,  
11 për të vijuar më tej drejt kufirit me ish-Republikën  
12 Jugosllave të Maqedonisë. 7000 kosovarë janë "dërguar" gjatë  
13 mbrëmjes së datës 31 mars 1999 deri në 1 prill 1999".

14 Kjo gjendet në dosjen gjyqësore në dokumentin me numër  
15 ERN IT-05-87.1 faqe 01029, apo në faqen 164. Ose me numrin  
16 tjetër 03525497. Është i njëjti numër faqeje si faqja 164.

17 Të nderuar Gjykatës, dëbimi me forcë është raportuar në  
18 raportin e OSBE-së të titulluar "Kosova, siç është parë, e siç  
19 është treguar", në kapitullin 14 dhe është një raport i cili  
20 gjendet publikisht. Sipas këtij raporti të OSBE-së, nga data  
21 24 mars deri më 2 prill 1999, mbi 177.500 shqiptarë të Kosovës  
22 kanë mbërritur në Shqipëri dhe më 2 prill 1999, 130.000  
23 shqiptarë të Kosovës kanë mbërritur në Maqedoni dhe Shqipëri,  
24 më 2 prill.

25 Shumica më e madhe e këtyre njerëzve janë dëbuar me forcë

1 nga shtëpitë. Dëbimet kishin për objektiv të qartë shqiptarët  
2 e Kosovës dhe mbështetej në kombësinë e tyre. Raporti i OSBE-  
3 së përshkruan modelin tipik të dëbimit me forcë të personave  
4 me kombësi shqiptare dhe po citoj:

5 "Në mënyrë tipike forcat serbe e granatojnë një fshat për  
6 disa orë, pas së cilës rezultati është që shqiptarët e Kosovës  
7 fshihen nëpër bodrume apo largohen për t'u fshehur nëpër  
8 kodra. Pastaj, me përfundimin e granatimit, forcat serbe  
9 përfshirë edhe policinë, ushtrinë jugosllave, hyjnë në fshat  
10 duke shtënë në ajër. Ata thyjnë dyert për të hyrë në shtëpitë  
11 e shqiptarëve të Kosovës, kërcënojnë të gjithë ata që të cilët  
12 nuk janë larguar dhe u japin urdhër të largohen ose menjëherë,  
13 ose pas pak minutash ose ndonjëherë edhe pas disa orësh.  
14 Ndonjëherë kryesia apo pleqësia e fshatit, thuhet se negocion  
15 zbatimin e kërkesave serbe. Ndonjëherë përzgjidhen disa serbë  
16 të caktuar lokal, që të përhapin fjalën se, shqiptarët duhet  
17 që të largohen. Ndonjëherë shtëpia e parë në të cilën arrijnë  
18 forcat serbe, përdoret si një shembull që u jepet fshatarëve  
19 të tjerë".

20 Dua të citoj edhe një herë raportin e OSBE-së, i cili  
21 thotë:

22 "Pasi një fshat spastrohej, forcat serbe shpesh  
23 ktheheshin pas disa ditësh në mënyrë që sërish të zbraznin  
24 fshatin nga personat të cilët ishin zhvendosur brenda vendit.  
25 Persona të cilët ishin kthyer dhe siguroheshin që nuk kishte



1 mbetur asnjë shqiptar i Kosovës atje. Ata jepnin një ultimatum  
2 të ri për t'u larguar duke i shoqëruar ultimatimet me  
3 kërcënime dhe me frikësime. Autobusë viheshin në dispozicion  
4 ose njerëzit urdhëroheshin që të shkonin në stacionet e  
5 hekurudhave ose dërgoheshin karvanë dhe ndonjëherë  
6 shoqëroheshin edhe në kufi".

7 Zhvendosja ka ndodhur në drejtime të ndryshme. Raporti i  
8 OSBE-së, të cilin unë e përmenda më sipër, përshkruan:

9 "Ndërkohë që disa prej të dëbuarve shkonin  
10 drejtpërsëdrejti në kufi, kishte qindra mijëra shqiptarë të  
11 Kosovës të cilët ishin zhvendosur brenda Kosovës. Shpesh për  
12 javë të tëra. Ndërkohë e fillimisht ata të cilët ishin dëbuar,  
13 ose të cilëve iu kërkoheshin që të largoheshin, në përgjithësi  
14 largoheshin vetëm brenda një distance të shkurtër nga shtëpitë  
15 e tyre. Kishte gjithmonë e më tepër grupe dhe persona të  
16 zhvendosur brenda vendit të cilët e gjenin veten që të  
17 lëviznin nga një fshat tek tjetri, nga një kodër në një fushë,  
18 derisa eventualisht kishte karvanë të gjatë me dhjetëra,  
19 qindra njerëzish të formuar".

20 "Fillimisht, kodrat mund të dukej sikur ofronin më shumë  
21 siguri se sa fshatrat të cilat granatoheshin. Por edhe ato u  
22 bënë vende të rrezikshme. Përveçse u kapën në shkëmbim zjarri  
23 në zonën ku kishte luftime ndërmjet forcave serbe/jugosllave  
24 dhe të UÇK-së, personat e zhvendosur brenda vendit ndonjëherë  
25 etiketoheshin edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë".

1 Të nderur Gjykatës, sërish është në këtë sfond dhe në  
2 këtë kontekst të ngjarjeve të cilat kanë ndodhur në Kosovë në  
3 periudhën pranë aktakuzës. Është me rëndësi që të theksohet se  
4 Mbrojtja beson se personat e zhvendosur brenda vendit, të  
5 cilët po kërkonin strehim brenda Kosovës, kërkonin strehim në  
6 zonën e Gollakut, në pjesën malore në lindje të Prishtinës.

7 Krimet të cilat pretendohet se kanë ndodhur, siç janë  
8 përshkruar në aktakuzë, përqendrohen tek zona malore e quajtur  
9 Gollak. Krimet e pretenduara thuhet se kanë ndodhur në zonën e  
10 Zllashit. Fokusi i aktakuzës është periudha nga 1 deri në 19  
11 prill të vitit 1999. Mbrojtja së pari dëshiron t'i hedhë një  
12 sy zonës ku pretendohet se kanë ndodhur krimet e parashikuara  
13 dhe të paraqitura në aktakuzë.

14 Zllashi. Nuk ka një material të përcaktuar në dosjen e  
15 çështjes gjyqësore rreth Zllashit. Ne e dimë me përafërsi se  
16 ku ndodhet Zllashi, por nuk ka një përcaktim kufijsh të qartë  
17 të kësaj zone. Ajo është një zonë e madhe, ku shtëpitë janë të  
18 shpërndara në të gjithë zonën. Nuk ka një qendër të Zllashit  
19 ose fshat i Zllashit. Në pikëpamjen administrative, zona e  
20 Zllashit bie nën Mramor, që është një fshat goxha më i madh në  
21 cep të zonës malore.

22 Për të shkuar në Zllash nga Prishtina, është goxha  
23 rrugëtim, veçanërisht për të shkuar në vendin e përcaktuar në  
24 aktakuzë. Është një udhëtim që kalon nëpër male, në pjesën  
25 dërmuese të kohës në rrugë të pashtuara. Është ftohtë gjatë

1 dimrit, rrugët janë plot me baltë dhe është shumë e vështirë  
2 që të udhëtosh me kerr.

3 Vendet që Mbrojtja do të diskutojë gjatë çështjes së  
4 Mbrojtjes, do të gjenden në vende të ndryshme. Vendet dhe  
5 distancat ndërmjet tyre janë çorientuese. Në hartë mund t'i  
6 gjesh dhe gjithashtu mund të matësh dhe distancat nga njëri  
7 vend tek tjetri. Megjithatë, në jetën reale dhe sigurisht në  
8 periudhën e vitit 1999, këto vende ishin shumë të vështira që  
9 të arriheshin.

10 Kishte lloj-lloj faktorësh të cilët luanin një rol për  
11 këtë. Së pari, postblloqet dhe zonat e kontrolluara nga serbët  
12 e bënë shumë të vështirë që të shkoje në vende të tilla. Mund  
13 të të duheshin orë të tëra ose edhe ditë apo edhe shumë  
14 pasazhe të ndryshme, të cilat do të duheshin të kaloheshin  
15 gjatë natës në zona malore ku nuk ka fare asnjë lloj ndryshimi  
16 dhe do duhej të kaloje në këto zona në mënyrë që të arrihej  
17 atje. Shumë shpesh duhej që të shkoje në këmbë. Një tjetër  
18 pjesë e vështirë e udhëtimit do të ishte thjesht që kishte  
19 përplasje të vazhdueshme ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe.  
20 Për të shkuar atje do të duhej që t'i anashkaloje këto zona,  
21 pasi ato ishin rrugë të rrezikshme për t'u përdorur. Do të  
22 duhej në realitet shumë herë më tepër kohë që të shkoje nga  
23 një vend tek tjetri.

24 Në këtë pikë, të nderuar Gjykatës, dua që t'i kërkoj  
25 Njësisë së Administrimit Gjyqësor që të na tregojë hartën

1 gjeografike që identifikohet me inicialet DSM-00443.

2 Mbase mund ta zmadhojmë pak, në mënyrë që të mund ta  
3 shohim pak më mirë dhe ta kuptojmë pak më mirë terrenin e  
4 zonës dhe të kuptojmë se për cilën zonë bëhet fjalë.

5 Mund të shohim Prishtinën këtu. Dhe nga Prishtina në  
6 hartë, nëse mund të shkojmë me kursor në të majtë, të kalojmë  
7 tek blloku tjetër që është blloku në mes të hartës që kemi  
8 përpara, aty mund të lexojmë të shkruar, Zllash. Po, këtu  
9 është. Zllashi është në vendin ku është kursori. Në qoftë se  
10 do të shkojmë pak më në jug të Zllashit, do të shohim fshatin  
11 Mramor. Gjendet në të njëjtin bllok, pak më poshtë. Po, këtu  
12 është Mramori. Shumë faleminderit.

13 Dua që së pari t'ju tregoj një rrugë në drejtim të  
14 lindjes në këtë hartë dhe dua që rrugën ta nisim me pikën e  
15 nisjes nga Prishtina. Pra, e nisëm nga Prishtina, shkojmë në  
16 lindje tek rruga e shënuar me ngjyrë të kuqe dhe në qoftë se  
17 do të ndjekim këtë trajektore, do të arrijmë në një vend që  
18 quhet Llukar. Po, këtu është Llukar. Dhe, në qoftë se do të  
19 ndjekim të njëjtën rrugë, do të shkojmë në Makovc. Në qoftë se  
20 do të ulemi pak më poshtë në bllokun tjetër, kemi vendin që  
21 quhet Grashticë. Dhe prej aty mund të dallojmë që kemi një  
22 ndarje të rrugëve dhe ekziston mundësia që, në qoftë se  
23 ndjekim rrugën mund të shkojmë nga Grashtica në Zllash. Ju  
24 lutem kalojeni këtë trajektore nga Grashtica në Zllash.  
25 Faleminderit.

1 Në qoftë se do të kthehemi sërish tek kjo shenja e madhe  
2 e kuqe në hartë.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
4 Avokat Mbrojtës, e keni fjalën për rrugën në të zezë, jo me të  
5 kuqe?

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, këtu përpara e kam me të  
7 kuqe.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo se  
9 bëhet fjalë për dy rrugë, një me të zezë dhe një me të kuqe.  
10 Prandaj doja ta sqaroja.

11 Z. VON BONE: [Përkthim] Atëherë, shkojmë dhe një herë në  
12 Makovc dhe nga Makovci do ta ndjekim më tej rrugën dhe do të  
13 shohim më në veri një vend që quhet Radashec. Dhe në qoftë se  
14 do ndjekim sërish të njëjtën rrugë, do të arrijmë në një vend  
15 që quhet Keçekollë. Dhe ne qoftë se do të vazhdojmë në të  
16 njëjtën rrugë, do të arrijmë në Prapashticë.

17 Nga Parapashtica dua që të tregoj një tjetër vend me  
18 rendësi, sepse në këtë hartë është rruga më e lehtë që të  
19 shkojmë nga Prapashtica. Pra, në qoftë se do të zbresim me  
20 kursorin, do të kalojmë në disa fshatra të vogla dhe do të  
21 arrijmë në një vend që quhet Bullaj. Është ekzakt ku është  
22 kursori tani. Shumë faleminderit.

23 Unë dua të tregoj një tjetër rrugë tani. Do të fillojmë  
24 sërish me pikën nistore në Prishtinë. Dhe do të shohim kufirin  
25 në lindje, në të djathtë të vendit ku është kursori tani,

1 është një vend që quhet Sofali. Nuk jam i sigurt se ku gjendet  
2 kursori tani, po në fakt - po, aty është kursori, tek vendi që  
3 quhet Sofali. Më pas, nëse vijojmë më tej në të djathtë nga  
4 kursori, do të shikojmë Butovcin. Ky është Butovci i Poshtëm.  
5 Ka një Butovc të Epërm dhe ka një Butovc të Poshtëm. Për  
6 Mbrojtjen, ne mendojmë që është e rëndësishme që të bëhet  
7 dallimi dhe të thuhet që bëhet fjalë për Butovcin e Poshtëm.

8 Në qoftë se do të kthehemi sërish në pikënisje, nga  
9 Prishtina, kemi edhe një opsion tjetër. Të shkojmë pak më  
10 shumë në jug-lindje, ku është një vend me emrin Matiçan. Dhe  
11 nga Matiçani, po ta ndjekim rrugën, do të përfundojmë përsëri  
12 në Butovc. Nuk mund ta shohim mirë, nuk e quajmë dot një rrugë  
13 shumë të mirë, por këtë në fakt donim të nxirrnim ne në pah,  
14 të tregonim.

15 Tani, duam të tregojmë disa vende të cilat janë në veri  
16 të kryeqytetit. Në qoftë se mund ta vendosim pak më poshtë të  
17 gjithë hartën, në qoftë se mund ta vendosim Prishtinën pak më  
18 poshtë. Zbriteni dhe pak më shumë. Tani ta zmadhojmë, mbase  
19 mund ta zmadhojmë edhe pak më tepër. Ja, këtu jemi. Këtu ne  
20 shohim me të kuqe, në fund të ekranit.

21 Këtu kemi Prishtinën. Në qoftë se ne do të ndjekim këtë  
22 rrugën tjetër të zezë që është sipër Prishtinës, në të majtë  
23 të kësaj rruge. Edhe pak më sipër edhe pak më sipër. Pra, nga  
24 këtu mund të shikojmë në të majtë një vend që quhet Barilevë.  
25 Nëse do ta çojmë kursorin pak më lart në të djathtë, do të

1 shohim një vend që quhet Vranidoll. Në të djathtë të  
2 Vranidollit mund të shohim një vend që quhet Rimanishtë. Dhe  
3 nëse shkojmë pak në jug të Rimanishtës, do të shohim  
4 Sharbanën. Dhe nëse shkojmë në bllokun tjetër, në qoftë se  
5 mund ta ngrini pak më shumë kursorin, arrijmë në vendin që  
6 quhet Koliq. Faleminderit.

7 Këto janë vendet të cilat për ne janë me rëndësi. Pra,  
8 janë me rëndësi për çështjen e Mbrojtjes.

9 Tani dua t'i kërkoj Njësisë së Administrimit Gjyqësor që  
10 të kalojmë tek harta tjetër. Është me numër DSM-00415.

11 Në fakt është një hartë që mbulon një sipërfaqe më të  
12 madhe. Nëse mund ta zmadhojmë që të shikojmë Prishtinën. Po,  
13 mjafton me kaq. Këtu shohim Prishtinën dhe nëse majën e  
14 kursorit e çojmë djathtas në vijën e hollë të kaltër që ndan  
15 disa blloqe në këtë hartë, shohim Zllashin. Po, ja ku është.  
16 Dhe diku më poshtë shohim Mramorin. Këtu në të djathtë të  
17 Zllashit dhe më në veri, shohim disi më mirë Prapashticën.

18 Nëse në këtë hartë, nëse nisemi nga Prishtina dhe shkojmë  
19 më në veri, duke e shfaqur Prishtinën në pjesën e poshtme ose  
20 nuk e zmadhojmë kaq shumë. Të vendosim hartën në ekran në atë  
21 mënyrë që të duket Prishtina.

22 Në këtë hartë shohim Prishtinën, në veri-lindje shohim  
23 Llukarën. Për Mramorin folëm tashmë. Dhe nëse vazhdojmë më në  
24 veri, do të shohim Barilevën disi në të majtë. Dhe nëse  
25 vazhdojmë të ndjekim të njëjtën rrugë më lart dhe këtu mbase

1 mund ta zmadhoni disi. Po. Të shkojmë më lart, më lart, aty.  
2 Shohim Llapashticën e Epërme. Ka edhe një Llapashticë të  
3 poshtme.

4 Nga këtu dua që të tregoj edhe një vendndodhje tjetër. Në  
5 të djathtë shohim një liqen, në hartë dhe në të djathtë të  
6 liqenit, është një vend që quhet Orllan. Se është një  
7 vendndodhje me rëndësi.

8 Nëse mund ta zvogëlojmë hartën tani, vendndodhjet shkojnë  
9 edhe më lart, me vende të tilla si Potok e kështu me radhë.  
10 Pra, harta vazhdon edhe më në veri se harta tjetër, të cilën  
11 sapo jua tregova.

12 Faleminderit shumë, znj. Sekretare.

13 Pra, tani që i lamë pas aspektet gjeografike, kemi  
14 arritur tek vendndodhja që mbulohet nga aktakuza.

15 Aktakuza përqendrohet tek një shtëpi, në të cilën  
16 pretendohet se janë mbajtur, keqtrajtuar, madje dhe torturuar  
17 njerëz. Kjo shtëpi do të duhej të gjendej në një vend të cilin  
18 ZPS-ja e quan kompleks. Pra, do të bënte pjesë në një grup të  
19 vogël shtëpiash, majë një kodre në zonën e Gollakut. Kjo  
20 vështirë se mund të quhet fshat. Është thjesht një grupim  
21 shumë i vogël objektësh të qëllimeve të ndryshme. Ky grupim  
22 objektësh vështirë se mund të përkufizohet si një fshat normal  
23 apo edhe si një fshat i vogël. Është një vendbanim me disa  
24 shtëpi, pa ndonjë përkufizim administrativ në zonën e  
25 Zllashit.



1 Dëshiroj që t'i kthehem për një çast hartës së mëparshme  
2 gjeografike, asaj të parës me numër DSM-00443. Nëse mund ta  
3 zmadhojmë, na nevojitet pjesa e sipërme e kësaj harte  
4 gjeografike. Po, mendoj se kaq mjafton ky nivel zmadhimi.

5 Ka një rrugë të veçantë, të cilën dëshiroj t'ia paraqes  
6 Trupit Gjykses. Kjo rrugë fillon në vendin e quajtur Surdull,  
7 që është në mes të katrorit të shënuar me K. Po, ja ku është  
8 Surdulla. Nga Surdulla shkojmë pak në të djathtë-lart në një  
9 vend të quajtur Turuçicë. Pastaj prej aty zbresim në një vend  
10 të quajtur Orllan.

11 Në këtë moment dua të ndaloj një çast, sepse ka dhe një  
12 mënyrë tjetër. Ka dhe një rrugë tjetër që do të thotë nga  
13 Turuçica, në të djathtë në bllokun tjetër të shënuar me  
14 shkronjën L, shohim një vend të quajtur Rakinicë. Dhe prej  
15 aty, nëse zbresim më në jug, kemi Kalaticën.

16 Prej aty kthehemi në katrorin e shënuar me shkronjën K,  
17 në jug të atij liqeni ka një vend të quajtur Ballaban.  
18 Pikërisht, këtë desha të theksoj. Dhe prej Ballabanit, do ta  
19 zhvendosim pak më lart hartën, zbresim deri në Keçekollë.

20 Prej aty dua të tregoj një vend të quajtur Koliq, që  
21 është pak a shumë në mes të këtij katrori, pikërisht këtu. Dhe  
22 prej aty më në perëndim në katrorin tjetër, në drejtim të  
23 Rimanishtës. Dhe prej aty, në drejtim të Vranidollit, që është  
24 pak a shumë në të njëjtin nivel. Dhe po ta kapërcejmë rrugën e  
25 zezë, ka një vend të quajtur Kozaricë. Dhe prej aty, po të

1 shkojmë lart, pak më lart, përfundojmë në Llapashticën e  
2 epërme.

3 Faleminderit shumë.

4 Të nderuar Gjykatës. Dëshiroj të flas për vendndodhjen e  
5 aktakuzës. Dhe kur flasim për vendndodhjen e aktakuzës, flasim  
6 për zonën e Zllashit.

7 Për këtë, i lutem Sekretares të paraqesë në ekran  
8 dokumentin me numër DSM-00389.

9 389 është kjo? Po. Në fakt nuk kërkojmë këtë. Kërkojmë  
10 ndjesë. Me numër DSM --. Do ta them me numër SPO-je. Me numër  
11 SPOE00213476.

12 Këtu kemi një fotografi të marrë nga ajri të zonës për të  
13 cilën flitet në aktakuzë. Mund të shohim nga një largësi e  
14 madhe se si janë të vendosura. Në njëërën pjesë ka një si fushë  
15 të sheshtë, nga ana tjetër ka shumë drunj, bjeshkë me pyll.

16 Po të kalojmë në tjetrën fotografi të marrë nga ajri, që  
17 është me numër SPOE00213478. Po.

18 Kjo është pamja nga ajri. Këtu vendndodhja duket më mirë.  
19 Ju lutem ta zmadhoni, mbase me 200%. Mbase diçka më shumë. Po,  
20 faleminderit. E kemi përdorur në shumë raste gjatë  
21 intervistave në mënyrë që të duken qartë objektet e ndryshme.

22 Ajo që dua të tregoj me këtë, është se mund të shohim në  
23 të djathtë një ndërtesë mjaft të gjatë, ndërtesa më e gjatë me  
24 një çati si në ngjyrë të bardhë, në këtë fotografi. Po,  
25 pikërisht kjo që po tregon Sekretarja. Dhe në vijë të drejtë

1 me atë është një ndërtesë e cila duket se i është dëmtuar  
2 çatia. Është në të majtë. Pikërisht ajo ndërtesë që po tregoni  
3 tani. Gjithsesi, në të dy anët ka një sërë objektësh. Po të  
4 shkojmë në pjesën e sipërme djathtas, edhe aty kemi një  
5 ndërtesë pa çati, që nuk ka më çati. Në anën tjetër të këtyre  
6 ndërtesave shohim një tog ndërtesash. Pra, kjo ndërtesa është  
7 e vetmja ndërtesë që gjendet edhe sot e kësaj dite. Sigurisht,  
8 do të flasim edhe për ndërtesat e tjera të cilat ndodhen aty,  
9 por i kemi parë në shumë raste.

10 Pastaj i lutem Sekretares që të zmadhojmë --. Por të  
11 kalojmë tek fotografia me numër SPOE00128388. Faleminderit  
12 shumë.

13 Është një fotografi e ndërtesës që përbën një prej  
14 elementëve kryesorë të kësaj çështje gjyqësore.

15 Do të shohim më pas, se jemi përpjekur përmes një grafike  
16 në 3 dimensione, që ta rindërtojmë. Më pas do ta shikojmë.

17 Këto janë objektet që janë në të majtë të fotografisë së  
18 mëparshme, ku duket kompleksi.

19 Tani ju lutem, të shfaqim fotografinë me numër SPOE  
20 00128405, sipas numrave të ZPS. Të njëjtat 3 strukturat, të  
21 cilat i pamë në foton e mëparshme, por nga një kënd tjetër.

22 Ju lutem kalojmë në fotografinë tjetër me numër  
23 SPOE00128392. Ky është objekti që sapo pamë që ndodhej në të  
24 majtë të fotografisë të marrë nga ajri, të vendndodhjes.

25 Dhe në fund fotografinë me numër 00128409.

1 Faleminderit shumë znj. Sekretare.

2 Kjo është ndërtesa që në fotografinë e marrë nga ajri, që  
3 pamë përpara, është fotografia pa kulm.

4 Dhe në fund dëshirojmë që të tregojmë, jo shumë larg prej  
5 këtij grupi ndërtesash -- ju lutem znj. Sekretare ta heqim  
6 këtë fotografi.

7 Jo shumë larg prej këtij grupi objektesh, ndodhej një  
8 ndërtesë e cila dikur ka qenë shkollë. Ishte e braktisur dhe  
9 nuk e ushtronte këtë funksion gjatë periudhës që mbulon  
10 aktakuza. Përmendet si shkollë. Për të arritur aty duhej të  
11 zbrisje kodrës, të shkoje teposhtë, nga grupi i objekteve të  
12 kompleksit. Mund ta tregojmë me një fotografi, që është  
13 fotografia me numrin SPOE00128412. Ko është ndërtesa e  
14 shkollës.

15 Tani do t'ju kërkoja që të kthehemi edhe njëherë tek  
16 fotografia me numër SPOE00213478. Kjo është fotografia.

17 Faleminderit shumë znj. Sekretare.

18 Kjo është pamja nga ajri. Ndërkohë, godinën e shkollës  
19 nuk mund ta shikojmë nga kjo fotografi dhe as nuk mund të  
20 shihet as nga fotografitë e mëparshme që pamë bashkërisht, pra  
21 nga fotografitë nga ajri. Arsyeja pse doja ta tregoja edhe  
22 njëherë këtë foto, është që ne jemi munduar që të rindërtojmë  
23 të gjithë zonën, në mënyrë që të krijojmë një ide të mirë të  
24 asaj që po trajtojmë. Kështu që, të nderuar Gjykatës, ne u  
25 përpoqëm që t'ju jepnim një aspekt vizual.

1 Për të pasur një qasje më të mirë të aktakuzës, ne e kemi  
2 parë pjesën e kompleksit hap pas hapi. Mbrojtja e ka bërë këtë  
3 gjë duke u mbështetur në konstatimet e veta, në atë çfarë ka  
4 ngelur nga strukturat e mëparshme, fotografitë e bëra,  
5 fotografi që janë administruar si pjesë të çështjes gjyqësore,  
6 intervistat me njerëzit si dhe masave të tjera dhe vëzhgimeve  
7 që ne kemi realizuar në të gjithë zonën të cilat janë të  
8 administruara dhe në dosjen e çështjes gjyqësore.

9 Për këtë arsye, doja t'i kërkoja Sekretares që të na  
10 tregonte hartën më të thjeshtë të bërë në atë kohë, që është  
11 dokumenti i shënuar si DMS-00386. Nuk e di nëse mund ta  
12 rrotulloni. Siç e thashë edhe më përpara, kjo është një hartë  
13 shumë, shumë e thjeshtë që ne e kemi ndërtuar bazuar në atë  
14 çfarë ka mbetur në terren. Ne kemi përdorur disa prej gjërave  
15 që kanë mbetur ende atje, si për shembull një pus uji. Është  
16 edhe një shkëmb i madh, që e kemi vendosur në të djathtë, në  
17 cep. Kemi reflektuar edhe pemën që është vënë në të njëjtin  
18 nivel siç edhe shkëmbi i madh.

19 Ndërkohë, tani do të kërkoja që të shfaqni DSM-00983 në  
20 ekran, ju lutem.

21 Këtu mund të shohim një hartë të situatës. Nuk jam i  
22 sigurt nëse të tregojmë dy foto ngjitur me njëra tjetrën, këtë  
23 foto dhe dokumentin SPOE00213478. Ju lutem zmadhoheni pak.  
24 Shumë faleminderit. Këtu ne kemi tregues të cilat ne i kemi  
25 zbuluar gjatë hetimeve tona, në mënyrë që të kemi një ide më

1 të qartë të terrenit për të cilin bëhet fjalë.

2 Nëse do të shohim foton në të majtë, shohim ndërtesën më  
3 të gjatë nga të gjitha ndërtesat e tjera dhe - do t'i kërkoja  
4 Sekretares që të shkonte atje me kursor - dhe në të djathtë të  
5 saj shikohet një pemë. Për këtë pemë e kam fjalën. Dhe në  
6 qoftë se do të shikojmë hartën, do të shihni po ashtu që kemi  
7 një shenjë që thotë aty, "pema F". Dhe në qoftë se do të  
8 kalojmë në vijën e drejtë, do të kalojmë tek pema B në hartë,  
9 e cila pasqyrohet në pjesën e majtë të fotografisë. Kjo është  
10 pema. Do ta shohim gjithashtu edhe të regjistruar në video pas  
11 pak.

12 Pra, ne kemi bërë kufizimin në dimensionet përkatëse,  
13 janë dimensione të cilat ne i kemi matur vetë dhe kjo është  
14 një hartë, e cila po ashtu përmban edhe legjendën. Reflektohet  
15 në letër milimetrike.

16 Nëse do të kalojmë në një tjetër dokument, është  
17 dokumenti DSM-00984, ky është dokumenti. Dhe nëse mund të  
18 tregoni përmbri ndërtesën e shkollës, foton e ndërtesës së  
19 shkollës, të cilën e pamë edhe pak më parë. Është dokumenti  
20 0012842 [sipas përkthimit]. Kjo është godina e shkollës. Pra,  
21 në qoftë se i krahasojmë këto dy pamje, është pak e vështirë  
22 që të kuptohet që bëhet fjalë për të njëjtën godinë, sepse nuk  
23 kemi pasur drone ose ndonjë fotografim nga ajri për t'ju  
24 treguar që bëhet fjalë për të njëjtën ndërtesë. Megjithatë,  
25 dua t'ju them që ne kemi bërë matje të asaj çfarë ka mbetur

1 nga kjo godinë dhe pastaj kemi bërë hartën e asaj çfarë ka  
2 mbetur. Hyrja, në fotografi, është në të djathtë në foto dhe  
3 është në të majtë në pjesën e hartës. Ndoshta mund t'i  
4 referoheni shigjetës këtu. Sekretarja mund të shkoi me kursor  
5 tek shigjeta për të treguar se ku është hyrja në këtë godinë.  
6 Ajo çfarë shohim në këtë fotografi është sipërfaqja që mund ta  
7 shikojmë në pjesën e poshtme të fotos.

8 Faleminderit, znj. Sekretare.

9 Nuk e di në qoftë se mund të vijojmë më tej me DSM-00985.  
10 Është e njëjta me hartën e mëparshme që pamë bashkërisht, duke  
11 reflektuar të gjitha matjet dhe neve këto harta ua kemi  
12 treguar gjithashtu edhe disa prej dëshmitarëve. Ndërtesa,  
13 godina e shënuar si 1, është e vetmja ndërtesë e cila ekziston  
14 edhe sot e kësaj dite. Pra, jemi munduar që të rindërtojmë  
15 terrenin ashtu siç ka ekzistuar ai në kohën e aktakuzës.

16 Megjithatë, siç e thashë, këto ditë pak gjë ka mbetur,  
17 thuajse nuk ka ngelur asgjë. Siç do ta tregojmë edhe përmes  
18 regjistrimit me video të ndërtesës dhe do shohim bashkërisht  
19 se si ndërtesa numër 1 duket aktualisht në terren.

20 Dua që të kërkoj që të transmetohet, të shfaqet një video  
21 e shkurtër, që mban numrin DSM-00451.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Avokat, videoja nuk do të transmetohet në publik. Por nga ana  
24 tjetër nuk e shmangim dot zërin që të shfaqet. Kështu që, në  
25 qoftë se doni që kjo të transmetohet në mënyrë konfidenciale,

1 atëherë duhet të kalojmë në seancë private.

2 Z. VON BONE: [Përkthim] Në rregull atëherë. Do të kalojmë  
3 në seancë private, të nderuar Gjykatës.

4 [Trupi Gjykues dhe Sekretarja e Gjykatës  
5 këshillohen]

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
7 qoftë se ka ndonjë tingull, ndonjë zë që shoqëron videon, mund  
8 të ulim zërin dhe në këtë pikë nuk na duhet që të kalojmë në  
9 seancë private.

10 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirë. Është më mirë që të mos  
11 kalojmë në seancë private. Kështu që le të ulim zërin dhe të  
12 transmetojmë videon.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
14 lutem vijoni, znj. Sekretare.

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Po. Përpara se të filloni, këtu  
16 mund të shohim ndërtesën numër 1 që e pamë edhe në hartë.  
17 Shikojmë gjithashtu edhe një vijë, është si një tel me të  
18 bardhë dhe me të kuqe, për të bërë matjet. Dhe aty e kemi  
19 filluar incizimin. Mund ta shikojmë të gjithë tani videon.

20 [Luhet videoincizimi]

21 Z. VON BONE: [Përkthim] Mendoj se kaq ishte.

22 Gjëja e parë që ju patë, mbase ishte pusi i ujit, që  
23 është një gjë rrethore e vogël. Gjëja tjetër është ndërtesa që  
24 ekziston edhe sot e kësaj dite atje.

25 Në mënyrë interesante, të nderuar Gjykatës --. Nuk jam i



1 sigurt nëse mund të vendosim një tjetër fotografi përbri saj,  
2 e kam fjalën për fotografinë SPOE00128388. Shumë faleminderit.

3 A mund ta zmadhojmë pak foton? Edhe pak më tepër, po.  
4 Zhvendoseni pak fotografinë në të majtë dhe zmadhoheni pak më  
5 tepër. Shumë faleminderit.

6 Pema që shohim aty është mbase ose jemi pothuajse të  
7 sigurt, që është pema që shohim në të djathtë të videos, në  
8 foton që kemi karshi.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
10 Avokat, Trupi Gjykses nuk është plotësisht i sigurt se për  
11 cilën pemë e keni fjalën.

12 Z. VON BONE: [Përkthim] Në qoftë se do të shikojmë këtë  
13 pamjen e ngrirë të videos, bëhet fjalë për pemën në të  
14 djathtë, jo, ju kërkoh ndjesë. Edhe një tjetër. Kjo është  
15 pema. Është një pemë që është e ndarë në dy degë. Dhe pema  
16 tjetër që është në të majtë të saj, kjo pema këtu që është dhe  
17 pak më sipër, është pema tjetër.

18 Tani ju lutem, më tregoni DSM-00389.

19 Dhe hiqeni nga ekrani këtë fotografinë.

20 Ky është një rikonfigurim në 3 dimensione i vendit,  
21 mbështetur në mënyrën se si e kujtojmë ne atë. Këto janë  
22 ndërtesat për të cilat kemi informacion ose nuk kemi  
23 informacion. Për shembull, mund të shikoni këtu në ekran  
24 ndërtesën më të gjatë fare, në të djathtë të ekranit. Pra,  
25 është ndërtesa në të djathtë të ekranit me ngjyrë gri. Ju

1 lutem vendosni kursorin mbi të. Po, për këtë ndërtesë bëhet  
2 fjalë dhe ne nuk kemi informacion lidhur me të.

3 Ndërkohë, ndërtesa tjetër më lart që ka të bardhë aty -  
4 nuk e di nëse mund ta zmadhoni pak më shumë fotografinë edhe  
5 pak më tepër? Kaq. Faleminderit.

6 Këtu mund të shikoni një si lloj verande dhe në dosjen e  
7 çështjes gjyqësore, ne kemi bërë ca matje dhe e kemi bërë  
8 reflektimin e kësaj ndërtesë kështu. Në qoftë se do të shkojmë  
9 pak më sipër me kursorin, zbrisni pak më poshtë, edhe pak më  
10 poshtë. Në të djathtë këtu, pikërisht këtu, është hyrja e asaj  
11 çfarë ne besojmë që është ndërtesa e bardhë, të cilën e pamë  
12 më përpara dhe që nuk kishte kulm fare. Në qoftë se do t'i  
13 referohemi fotografive që janë marrë nga ajri.

14 Në qoftë se do ta zvogëlojmë sërish fotografinë, në të  
15 majtë do të shohim ndërtesat e tjera.

16 Ndërtesa e tretë nga fundi, ajo ndërtesë. Mund të shikoni  
17 që kemi vendosur edhe pemën pranë saj nga njëra anë edhe pemën  
18 nga ana tjetër. Dhe godina numër 1 është aty përsëri, është  
19 pak më sipër se sa ndërtesa ku është kursori tani. Po, atë.  
20 Pikërisht atë.

21 Faleminderit shumë.

22 Është një pamje e marrë nga lart. Kemi edhe një pamje në  
23 nivel plani horizontal, të themi. Është numri DSM-00387. Kjo  
24 është pak a shumë në nivelin që thamë, planin horizontal, që  
25 është vështirë ta paraqesësh në 3 dimensione. Gjithsesi, ideja

1 është që shkon, ngrihet lart në kodër. Kalojmë tani tek  
2 fotografia tjetër që është DSM-00398. Kjo është fotografia dhe  
3 ju lutem, përbri saj vendosni hartën 985. Faleminderit.  
4 Zmadhojeni pak hartën, ju lutem. Faleminderit shumë.

5 I lutem Sekretares që me kursoren të kalojë tek  
6 fotografia 3 dimensionale, tek ndërtesa e parë, ajo me ngjyrë  
7 të zezë, në qoshen e djathtë të poshtme. Aty janë ato masat që  
8 morëm, 23 metro. Ajo pjesë është ndërtesa që qëndronte më vete  
9 dhe i morëm tjegullat i matëm. Ishte në fakt një punë mjaft e  
10 madhe, të cilën Prokuroria na detyroi të bënim, të matnim, të  
11 numëronin të gjitha tjegullat për të dalë me dimensionet e  
12 saktë të ndërtesës kryesore në këtë kompleks ndërtesash.  
13 Kështu vepruam.

14 Në rregull. Mbaruam me këtë, të nderuar Gjykatës. Ju  
15 faleminderit.

16 Dhe së fundi, dëshirojmë të paraqesim DSM-00410. Është e  
17 njëjta pamje por ne rrimë në pjesën e poshtme të këtij  
18 kompleksi dhe që aty ngremë sytë lart dhe shohim lart në  
19 kodër, të themi. Dhe shohim një shtyllë.

20 Dhe së fundmi, ju lutem paraqisni DSM-002412. Dhe aty  
21 vendosni përbri SPOE00213478. Ju lutem zmadhojeni fotografinë.  
22 Faleminderit.

23 Në krahun e djathtë shohim përfaqësimin në 3 dimensione.  
24 Shkoni me kursoren tek ndërtesa ngjyrë gri. Dhe përkundrejt asaj  
25 është një tjetër ndërtesë gri. Atë e shohim këtu në fotografi

1 në krahun e majtë, siç e shihni, këtë ndërtesë. Po të vemi  
2 poshtë, ulemi poshtë me kursor, pak më poshtë akoma, duket  
3 sikur aty ka një hyrje, një portë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
5 Avokat, të lutem, keni parasysh se po i afrohem orës 11.00.

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Të mbaroj këtë pjesë dhe pastaj  
7 bëjmë pushimin dhe vazhdojmë me pjesët e tjera.

8 Është vështirë të shihet, por po ta zmadhojmë edhe më  
9 shumë fotografinë në krahun e majtë, përsëri edhe pak më  
10 shumë, nëse është e mundur. Jo, me sa duket. OK atëherë. Aty  
11 ku është kursori ju lutem, ngrijeni pak më lart, ne krahun e  
12 majtë tani, është vështirë të shihet në fotografi.

13 Desha të them vetëm se aty ne pamë atë hijen e shtyllës,  
14 mund të jetë shtyllë elektrik, nuk e di. Por ishte aty dhe  
15 ajo vazhdon të jetë edhe sot. Duket në fotografi po të  
16 zmadhohet më shumë, por me sa duket nuk mundemi ta bëjmë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Me sa  
18 kuptoj unë, ju thatë hija e shtyllës, kështu thatë?

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Po. Po ta zmadhojmë fotografinë  
20 në fakt duket edhe hija e shtyllës. Se me paraqitjen e formës  
21 3 dimensionale dukej qartë. Aty ka qenë një pemë e cila nuk  
22 është më, por shtylla është. Dhe kur po shihnim fotografinë në  
23 krahun e majtë, e zmadhuam dhe aty shihej qartë. Prandaj e  
24 shpjegova pse ishte ajo shtylla aty.

25 Do ta përfundoj këtë pjesë dhe mbase do të ishte çasti më

1 i mirë të përfundonim këtë pjesë.

2 Bëmë një vizitë të fundit në këtë vend dhe vumë re se ajo  
3 zonë është duke u rindërtuar, prandaj në afërsi pamë një  
4 ndërtesë të re të bardhë. Me sa duket po bëhet një projekt  
5 zhvillimor.

6 Mendoj se është çasti më i mirë, e nderuar Gjykatëse, për  
7 të ndaluar tani për të bërë pushim. Nuk është se kemi dhe  
8 shumë ende për të vazhduar, por gjithsesi është mirë që ta  
9 ndërpresim tani.

10 Ju faleminderit për vëmendjen.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
12 Faleminderit. Pas pushimit do t'i kthehem përsëri pyetjes që  
13 ju bëra në fillim dhe për pak çaste do të kalojmë në seancë  
14 private. Në varësi të asaj që do të rezultoi nga ai diskutim,  
15 mund të jap ndonjë urdhër me gojë.

16 Pastaj do të vazhdojmë me deklaratën hapëse të Mbrojtjes.  
17 Dhe në fund do t'i kthehem përsëri Prokurorisë me një pyetje  
18 të vogël lidhur me përgatitjen e parashtrimeve.

19 Bëjmë pushim gjysmë ore tani.

20 Z. VON BONE: [Përkthim] Dhe unë do të doja të flisja me  
21 klientin në telefon.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
23 Ndërpritet seanca këtu.

24 --- Pauza fillon në orën 11.00

25 --- Seanca rifillon në orën 11:30

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Uluni  
2 ju lutem.

3 Nuk shikoj që kemi vendosur lidhjen me z. Mustafa.

4 Në rregull, mirë se erdhët, z. Mustafa, sepse nuk kishim  
5 lidhjen me ju paraprakisht.

6 Për hir të procesverbalit, palët kanë të njëjtën përbërje  
7 si para pushimit.

8 Znj. Sekretare, të kalojmë në seancë private.

9 [Seancë private]

10 [Seancë private teksti i fshirë]

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21 [Seancë e hapur]

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Faleminderit.

25 I nderuar Mbrojtës. Gjykata ka parasysht parashtrimet

1 tuaja.

2 Të kalojmë tani përsëri në seancë private.

3 [Seancë private]

4 [Seancë private teksti i fshirë]

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19 [Seancë e hapur]

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Faleminderit, znj. Sekretare.

22 Z. Mbrojtës, e keni fjalën, mund të vazhdoni me fjalën

23 hyrëse.

24 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar

25 Gjykatëse, vetëm edhe dy fotografi do t'i kalojmë dhe pastaj

1 do të vazhdoj me diçka tjetër.

2       Është një fotografi me numrin SPOE00128388. Dhe e dyta që  
3 mund të vendoset përbri kësaj të parës, është me numër  
4 SPOE00128392.

5       Ndoshta mund ta zmadhojmë pak fotografinë në anën e  
6 majtë, vetëm pak. Tani edhe këtë të djathtë. Në rregull. Të  
7 nderuar Gjykatës, ndoshta është më kollaj -- shihet më mirë në  
8 anën e majtë, e shikojmë atë drurin që është në anën e majtë  
9 te ajo dera e vogël. Është kjo që më parë e thamë, drurin që e  
10 përmendëm dhe që shihet në fotografi të tjera. Shihet edhe te  
11 kjo në anën e djathtë. Kjo ndërtesë, ky objekt, për mendimin  
12 tonë është një ndërtesë normale për një lloj përdorimi, pra  
13 nuk është ndonjë stallë lopësh apo diçka tjetër, siç kemi  
14 dëgjuar nga të tjerët gjatë këtyre procedurave. Të paktën për  
15 mendimin tonë. Dhe në fund mund të vazhdojmë, mund t'i heqim  
16 fotografitë nga ekрани. Faleminderit.

17       Të nderuar Gjykatës, gjatë vizitës së fundit që patëm,  
18 vërejtëm se kishte një ndryshim të madh të situatës, të  
19 gjendjes. Ajo zonë po zhvillohet.

20       Zona e Gollakut dhe brenda saj Zllashi, janë, siç e pamë  
21 më herët, në lindje të Prishtinës. Duke qenë se Mbrojtja hapi  
22 këtë deklaratë me përfundimet e raportit të OSBE-së, kjo zonë  
23 malore është më shumë afër Prishtinës, relativisht afër  
24 Prishtinës, do të thosha. Pas sulmeve ajrore të NATO-s,  
25 njerëzit filluan të largohen kudo që kishin mundësi të shkoni



1 dhe në mes këtyre zonave ishte edhe Gollaku dhe vetë Zllashi.  
2 Njerëzit strehoheshin në shtëpitë e banorëve të banorëve të  
3 asaj zone.

4 Tani të kalojmë te BIA. Të nderuar Gjykatës, Salih  
5 Mustafa ishte komandanti i njësitit BIA. Ky njësit i kryente  
6 detyrat e veta kryesisht me ndihmën e civilëve. Njerëzit ua  
7 jepnin shtëpitë apo pjesë të shtëpive të tyre njësitit, në  
8 mënyrë që të mblidhej informacion nga forcat e armikut,  
9 dislokimin e atyre forcave, thjesht që këto shtëpi të  
10 përdreshin për grumbullimin e materialeve të nevojshme për  
11 njerëzit, në mënyrë që ata të mbijetonin konfliktin. Sikurse  
12 ka theksuar tashmë Mbrojtja, zona e operacioneve të BIA-s  
13 ishin zonat urbane. Kryesisht Prishtina. Anëtarët e BIA-s  
14 qëndronin në shtëpitë e civilëve në mënyrë që pushonin apo të  
15 qëndronin për një kohë të caktuar gjatë kohës që ishin në  
16 lëvizje.

17 Mbrojtja konteston gjithë idenë se ka pasur një bazë në  
18 Zllash. Fjala "bazë" sugjeron sikur i gjithë kompleksi të ketë  
19 qenë nën kontrollin e BIA-s. Ky deduktim është plotësisht i  
20 gabuar. Zllashi për anëtarët e BIA-s ishte e njëjta gjë si për  
21 të tjerët. Ata mund të qëndronin në Zllash për të pushuar. Për  
22 ta ishte një lloj shtëpie e sigurt, një vend relativisht i  
23 sigurt që ndahej, apo ku qëndronin edhe pjesëtarë të njësive  
24 të tjera të UÇK-së. Pas një pune intensive në zonat urbane,  
25 anëtarët e BIA-s kishin nevojë për një shtëpi të sigurt ku do

1 të mund të qëndronin dhe të pushonin në mënyrë të sigurt,  
2 relativisht larg nga zona e veprimit.

3 ZPS-ja ka ndërtuar gjithë çështjen e vet rreth kësaj dhe  
4 bën që ajo të duket sikur njësia BIA ose Salih Mustafa, kanë  
5 qenë aty gjithë kohës dhe e kanë kontrolluar gjithë kompleksin  
6 dhe qendrën e ndalimit. Është plotësisht e gabuar ajo që  
7 deklaroi ZPS-ja në dosjen paraprake, konkretisht se BIA e ka  
8 përdorur këtë vend si shtab të vetin. Zona e operacioneve, apo  
9 veprimeve të BIA-s nuk ishte në Zllash. Atëherë parashtrohet  
10 pyetja, pse ta kishte BIA një shtab aty? BIA nuk kishte  
11 kurrfarë lidhje me Zllashin. Ata thjesht ndoshta kanë qëndruar  
12 në një dhomë aty në kohën kur operacionet nëpër qytete kanë  
13 qenë shumë intensive, në mënyrë që të mund të pushonin në  
14 zonën malore.

15 Salih Mustafa është vetëdeklaruar i pafajshëm në lidhje  
16 me të gjitha akuzat. Ai në asnjë mënyrë nuk i ka shkaktuar dëm  
17 asnjë prej dëshmitarëve që kanë dëshmuar për ZPS-në. Ai me  
18 vendosmëri mohon se ka pasur ndonjë lidhje me ta apo që ju ka  
19 shkaktuar atyre ndonjë të keqe. Viktimat, pavarësisht se çfarë  
20 kanë përjetuar, janë thjesht gabim dhe asnjëherë nuk e kanë  
21 identifikuar të akuzuarin. Në qafoftë se janë mbajtur apo janë  
22 maltrajtuar dukshëm që këtë nuk e kanë përjetuar nga Salih  
23 Mustafa dhe ai asnjëherë nuk ka urdhëruar një gjë të tillë.

24 Salih Mustafa nuk ka pasur kurrfarë kompetencash në zonën  
25 operative të Llapit. Ai nuk pasur kurrfarë pushteti mbi

1 Brigadën 153 që ka vepruar në zonën e Zllashit.

2 Salih Mustafa asnjëherë nuk e ka ndaluar asnjë person.

3 Salih Mustafa asnjëherë nuk e ka maltrajtuar asnjë  
4 person.

5 Salih Mustafa asnjëherë nuk ka vrarë asnjë person dhe as  
6 që ka urdhëruar dikë tjetër që të bënte një gjë të tillë.

7 Salih Mustafa, me shumë të tjerë, është një patriot dhe  
8 ka luftuar për çlirimin e vendit të vet kundër një nga  
9 regjimeve më shtypëse në historinë bashkëkohore.

10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

15 Mbrojtës, jemi në seancë publike. Kjo është një temë që nuk  
16 është për seancë publike.

17 Z. VON BONE: [Përkthim] Atëherë të kalojmë në seancë  
18 private. Faleminderit.

19 [Seancë private]

20 [Seancë private teksti i fshirë]

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18 [Seancë e hapur]

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

20 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit.

21 Të nderuar Gjykatës, akuzat kundër z. Mustafa përfshijnë

22 ndalimin arbitrar të disa individëve, trajtimin çnjerëzor,

23 torturën dhe vrasjen e paligjshme. Edhe një herë theksojmë se

24 z. Mustafa nuk i ka kryer asnjërin prej këtyre krimeve.

25 Me 4 shkurt të vitit 2022, ZPS-ja mbylli çështjen e vet.

1 ZPS-ja thirri disa dëshmitarë, të cilët folën për ndalimin e  
2 tyre, për keqtrajtimin e tyre, dhe për kushtet në të cilat u  
3 mbajtën të ndaluar. Salih Mustafa nuk ka bërë asgjë kundër  
4 asnjërit prej këtyre personave. Ai nuk i njeh ata, ai nuk ka  
5 kurrfarë motivi për t'ju shkaktuar dëm atyre në ndonjë mënyrë  
6 dhe ai nuk ka pasur autoritet apo kompetenca në atë zonë, nuk  
7 ishte pjesë e Brigadës 153, e cila ishte e vendosur në atë  
8 zonë gjatë kohës së aktakuzës. Shkurtimisht, Salih Mustafa nuk  
9 ka pasur kurrfarë lidhje me asnjë prej atyre personave.

10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]. Një dëshmitar tjetër që thirri

14 ZPS-ja për të dëshmuar, dëshmoi se Salih Mustafa nuk u përfshi  
15 në keqtrajtimin e askujt dhe s'kishte lidhje me atë  
16 keqtrajtim.

17 Ne nuk mendojmë, të nderuar Gjykatës, që dëshmitarët që i  
18 solli ZPS-ja për të dhënë dëshmi, ishin viktima të z. Salih  
19 Mustafa. Pjesa më e madhe e dëshmitarëve asnjëherë nuk e  
20 kishin njohur z. Mustafa dhe asnjëri prej tyre nuk e  
21 identifikoi atë siç duhet. Dëshmitarët thjesht thanë një emër  
22 pa e ditur se cili ishte personi prapa atij emri, duke e  
23 përshkruar një person në hollësi që nuk e kishin njohur  
24 asnjëherë përpara luftës, madje edhe pas luftës.

25 Prandaj ne besojmë se ZPS-ja nuk arriti të paraqiste

1 provat të cilat përmbushin kriterin e domosdoshëm për të  
2 vërtetuar jashtë dyshimit të arsyeshëm se z. Mustafa ka kryer  
3 krimet që akuzohen në aktakuzë. Akuzat janë të gabuara dhe z.  
4 Mustafa duhet të shpallet i pafajshëm për krimet që i  
5 ngarkohen.

6 Mbrojtja nuk ka nevojë të provojë se z. Mustafa nuk i ka  
7 kryer këto krime. Megjithatë, ne paraqesim çështjen tonë.  
8 Mbrojtja nuk mund të bëjë një rrëfim minutë për minutë, ditë  
9 për ditë se ku ka qenë z. Mustafa. Madje kjo gjë as që mund të  
10 kërkohet dhe nuk mund të kërkohet deh nuk mund të rindërtohet,  
11 mbasi ka kaluar një periudhë kaq e gjatë kohe.

12 Megjithatë, në javët që do të vijjnë, Gjykata do të  
13 dëgjojë dëshminë e njerëzve të cilët do të flasin për -- nga  
14 njëra anë se ku ka qenë ai dhe nga ana tjetër, për situatën që  
15 ka qenë në Zllash.

16 Kompleksi i Zllashit është themeli i kësaj mbi të cilin  
17 është ndërtuar kjo çështje dhe ne kemi dëshmitarë që kanë qenë  
18 në terren në atë periudhë, për të cilën akuzohet në aktakuzë,  
19 për kohën për të qenë më të saktë që është vënë në dukje në  
20 aktakuzë. Unë shpresoj vërtetë se ZPS-ja do të dëgjojë atë që  
21 kanë për të thënë dëshmitarët e Mbrojtjes. Dhe shpresoj që  
22 ZPS-ja do ta rishqyrtojë qëndrimin e vet, për të dëgjuar me  
23 një vesh të hapur dhe për të parë me sy të hapur atë që thonë  
24 tjerët lidhur me të akuzuarin lidhur me situatën në Zllash, me  
25 qëllim për të hedhur dritë mbi të vërtetën e kësaj çështjeje

1 në lëndën që po diskutojmë këto.

2 ZPS-ja nuk arriti të hetonte asnjë nga bashkëkryerësit e  
3 pretenduar që përmenden në aktakuzë. Mbrojtja vret mendjen  
4 nëse kjo gjë është bërë qëllimisht apo nga frika se mos dëgjon  
5 diçka tjetër që mund ta dëmtonte çështjen e tyre. Mbrojtja  
6 beson se këta njerëz mund të ishin gjetur. Ne mund të nxjerrim  
7 konkluzionet tona se për një arsye ZPS-ja nuk e bëri këtë.

8 Dua të përfundoj se Mbrojtja do të paraqesë këtu prova.  
9 Ne jemi të bindur fuqimisht se z. Mustafa nuk është fajtor për  
10 akuzat e ngritura kundër tij, bazuar në materialin që ne  
11 mundëm të gjenim. Ne nuk kemi nevojë të provojmë pafajësinë e  
12 tij, sepse një person gjithmonë prezumohet i pafajshëm deri sa  
13 të provohet përtej dyshimit të arsyeshëm se ai person në fakt  
14 ka kryer krimet për të cilat akuzohet në aktakuzë. Mbrojtja  
15 është e bindur dhe është e vendosur në qëndrimin e saj se z.  
16 Mustafa është i pafajshëm dhe se duhet liruar nga të gjitha  
17 akuzat, pra duhet të shpallet i pafajshëm.

18 Të nderuar Gjykatës, me kaq e përfundoj deklaratën time  
19 hapëse dhe ju falënderoj për vëmendjen.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
21 Faleminderit.

22 Këtu përfundon deklaratata hapëse e avokatit të Mbrojtjes.  
23 Nesër do të vazhdojmë me dëgjimin e dëshmitarit të parë të  
24 Mbrojtjes dhe në këtë kuadër dëshiroj të diskutoj sa më poshtë  
25 vijon me ZPS-në.

1           Sot në mëngjes morëm një email në orën 8.45 nga ZPS-ja ku  
2   thuhet se Mbrojtja dhe avokati i Mbrojtjes i kanë bërë të  
3   njohura një grup dokumentesh. Paneli konstaton se data është  
4   2003 për disa nga provat dhe janë artikuj të medias, të datës  
5   2011 deri në 2021. Disa prej tyre duket se nuk janë bërë të  
6   njohura më parë nga ZPS-ja. Gjithashtu, Paneli vë në dukje se  
7   në përputhje me paragrafin 31, palët dhe Avokati i Viktimave  
8   mund të përdorin materialet të cilat janë bërë të njohura  
9   gjatë marrjes së pyetjes të dëshmitarëve [sipas përkthimit].  
10   Ndryshe duhet kërkuar leje me shkrim ku të vihet në dukje se  
11   për se materiali nuk është nxjerrë më përpara. Paneli do të  
12   dijë nëse janë artikuj apo prova që janë zbuluar kohët e  
13   fundit dhe pse janë nxjerrë tani në këtë çast, dhe nëse këto  
14   kanë rëndësi për kundër pyetjet.

15           Z. Prokuror, keni fjalën.

16           Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit shumë.

17           Në fakt kemi shtuar disa artikuj apo disa prova që nuk  
18   ishin më përpara në listën e Prokurorisë. Shumica e tyre janë  
19   postime, fotografi, materiale të marra nga Facebook-u,  
20   materiale me burime të hapura dhe apo ashtu siç ishte rasti me  
21   Fatmir Humollin, që e morëm këtu para disa javësh, gjithashtu  
22   përdorëm informacion të marrë në Facebook. Dhe në rastin e  
23   dëshmitarit të parë të Mbrojtjes, do të përdorim disa  
24   informata publike sepse besojmë që mund të na nevojiten që të  
25   vlerësojmë më mirë apo t'ju ndihmojmë juve si Panel, për të



1 vlerësuar kredibilitetin e këtij dëshmitari. Kjo është arsyeja  
2 se përse këto materiale janë përfshirë në listën tonë të  
3 provave.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
5 Momenti i nxjerrjes sot në mëngjes dhe jo më përpara, pse?

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Meqë jemi duke u përgatitur për  
7 pyetjet e këtij dëshmitari -- tonat si Prokurori, pra ditët e  
8 fundit kemi rishikuar të gjithë informacionin e disponueshëm.  
9 Gjithashtu, duke pasur parasysh atë që përmban deklaratat e  
10 dëshmitarit të parë të Mbrojtjes, e kuptuam se mund të kishim  
11 nevojë për këto dokumente. Por do t'i përdorim vetëm nëse  
12 është e nevojshme, në varësi të ecurisë së pyetjeve që do t'i  
13 bëjmë këtij dëshmitari.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
15 Faleminderit.

16 Avokate e Viktimave, dëshironi të thoni diçka?

17 ZNJ. PUES: [Përkthim] Jo, nuk kam asgjë.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
19 Avokati i Mbrojtjes, dëshironi të përgjigjeni?

20 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, ne kundërshtojmë faktin që ky  
21 material që nxirret kaq me vonesë të -- do të jetë në gjendje  
22 të bëhet pjesë e procedurave. Pavarësisht se cili është ky  
23 material, ne mendojmë se nuk lidhet me asnjë nga faktet,  
24 rrethanat e çështjes me të akuzuarin apo me gjithçka. Pra nuk  
25 shohim ndonjë themel me këtë material, i cili tani po

1 paraqitet. Madje as nuk shoh se çfarë informacioni personal  
2 mund t'i shtonte besueshmërisë së dëshmitarit.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk e  
4 kuptova?

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Ne nuk kuptojmë se çfarë do të  
6 bënte ky material, apo çfarë do të ndryshonte lidhur me  
7 faktet, rrethanat, apo qoftë edhe me të akuzuarin. Dëshmitari,  
8 çfarëdo që të thotë në jetën e tij private, nuk është diçka me  
9 rëndësi që të kërkohet material nga jeta private e një personi  
10 për të thënë pastaj që ky person në një farë mënyre  
11 diskreditohet nga ato që ka shkruar apo që ka deklaruar për  
12 Mbrojtjen, për Prokurorinë. Mendoj që është më mirë që ta  
13 kufizojmë fushëveprimin e pyetjeve këtu.

14 Pra e kundërshtojmë materialin e kërkuar dhe nuk është  
15 hera a parë që na ndodh kjo gjë, që na paraqitet një material  
16 në minutën e fundit dhe nëse do të miratohet, shpresoj vërtetë  
17 që do të ishte hera e fundit që vihem në këtë situatë. Duhet  
18 të mësojmë që me kohë pra, kush janë dëshmitarët dhe jo në  
19 minutën e fundit të paraqiten materiale të tilla, sepse nuk  
20 kemi mundësi të përgatitemi. Kaq kishim.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
22 Faleminderit.

23 Po, Prokuror. Vazhdoni.

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ju kërktoj ndjesë që mora  
25 përsëri fjalën por dua të them diçka lidhur me nxjerrjen me

1 vonesë të materialit. Mbase nuk isha i qartë kur fola për këtë  
2 çështje. Nuk synojmë në fakt që këto materiale t'ja shtojmë  
3 listës së provave të materialeve tona dhe nuk është ky synimi.  
4 Vetëm dua t'i përdorim për pyetjet tona shtesë për të  
5 vlerësuar kredibilitetin e tij.

6 Ne besojmë, dhe ky është kundërargumenti im lidhur me  
7 rëndësinë e tyre, ne besojmë se një marrëdhënie e ngushtë me  
8 të akuzuarin e dëshmitarit të parë të Mbrojtjes është me  
9 rëndësi dhe çështja e qëndrimit të tij të mundshëm ndaj kësaj  
10 Gjykate, gjithashtu është i rëndësishëm. Të gjitha kanë  
11 çështje që lidhen me kredibilitetin e tij, por jo vetëm me  
12 atë.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
14 Faleminderit.

15 Avokatja e Viktimës?

16 ZNJ. PUES: [Përkthim] Shumë shkurt. Facebook-u nuk mund  
17 të thuhet se është privat. Është një burim i medias, burim  
18 social dhe si i tillë duhet trajtuar. Dhe nëse i kuptova  
19 drejtë parashtrimet e mëparshme, nuk mbulohet nga asnjë arsye  
20 tjetër. Kaq sa për të thënë diçka lidhur me këtë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
22 Faleminderit.

23 Avokati i Mbrojtjes?

24 Z. VON BONE: [Përkthim] Në fakt nuk shohim, nuk kuptojmë  
25 se çfarë ka zgjedhur ZPS-ja -- çfarë ka zgjedhur dhe çfarë nuk

1 ka zgjedhur nga Facebook-u. Në fakt nuk e kuptojmë se çfarë  
2 themeli do të kishte kjo gjë, prandaj nuk mendoj se është me  
3 vend të zgjedhësh disa postime që një palë apo dikush mund t'i  
4 gjejë që në një farë mënyrë lidhet me kredibilitetin.

5 Cilado qofshin mendimet e një personi lidhur me Gjykatën,  
6 me ZPS-në, apo me Mbrojtjen, apo me të akuzuarin, në fakt nuk  
7 e kuptoj se si do të dëmtonte kjo dëshminë e një personi të  
8 tillë. Nuk është se po e pyesim se ç'mendon për këtë apo për  
9 atë. Ne po e pyesim konkretisht, çfarë patë. Ku ishit, me kë  
10 ishit, pse ishit aty. Çfarë patë, çfarë nuk patë, çfarë  
11 përjetuat, çfarë nuk përjetuat, çfarë bëtë, çfarë nuk bëtë dhe  
12 jo se ç'mendon personi brenda vetes së vet të cilat i ka  
13 nxjerrë pastaj përmes një organi të medias. Nuk mund të themi,  
14 domethënë, që pse mendon kështu - nuk je i besueshëm.

15 Ne duhet ta vlerësojmë një dëshmitar në bazë të asaj që  
16 ka parë, që ka dëgjuar, ka bërë, ka përjetuar. Kjo është ajo  
17 që na nevojitet ne. Gjithçka tjetër është -- nuk ka lidhje,  
18 nuk kanë lidhje me këtë çështje. Faleminderit.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit, Avokat.

21 Do të jap një urdhër me gojë për këtë kërkesë.

22 Paneli konstaton se nxjerrja e materialit të ri nga ZPS-  
23 ja u bë një ditë përpara deponimit të dëshmitarit 200, që i  
24 dha Mbrojtjes kohë të kufizuar të njihet me materialin.

25 Paneli, megjithatë mendon se ZPS-ja i mori këto materiale pasi

1 kishte dorëzuar listën e saj të provave materiale në 14 mars,  
2 që është parashtrimi 343 dhe sot ka kërkuar të shpjegojë se  
3 pse është nxjerrë me vonesë. Jo më përpara, Paneli vëren se  
4 për të gjykuar kredibilitetin e një dëshmitari, ZPS-ja mund të  
5 përdorë materiale të cilat nuk lidhen me akuzat.

6 Prandaj e lejojmë ZPS-në ta përdorë këtë material gjatë  
7 pyetjeve të dëshmitarit 200 dhe nëse Mbrojtja dëshiron, do t'i  
8 jepet kohë shtesë gjatë pushimeve -- duke i zgjatur pushimet,  
9 për t'i konsultuar këto materiale dhe për t'u konsultuar me z.  
10 Mustafa në përgatitjen e tyre.

11 Këtu përfundon urdhri im me gojë.

12 Dhe tani po u drejtohem palëve, Avokates së Viktimave,  
13 nëse kanë ndonjë gjë për të diskutuar lidhur me nesër.

14 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo.

15 ZNJ. PUES: [Përkthim] Jo.

16 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nëse  
18 nuk ka asgjë tjetër për të ngritur, nesër do të diskutojnë  
19 dëshmitarin e parë të Mbrojtjes.

20 I falënderoj palët, Mbrojtësen e Viktimave për  
21 pjesëmarrjen, përkthyesit, stenografin, teknikët, sigurinë për  
22 ndihmën e tyre. Dhe sot mbarojmë.

23 Nesër në orën 9.30 mblidhemi përsëri.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të gjithë në këmbë.

25 --- Seanca mbyllet në orën 12:07